



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Nr: 01 104/02-13732

Kryetari i Komunës Besim Ilazi së bashku me ekzekutivin komunal ka hartuar Raportin e punës për periudhën gjashtë mujore- janar- Qershor 2024, të cilin e prezantoi para qytetarëve, duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, lëshon këtë:

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, neni 68 pika 68.1, Statutit të Komunës, nenit 10 pika 1 dhe 2 e Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për transparencë në komuna, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim me Publikun organizojnë:

Takimin e parë publik me qytetarë

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, organizoi takimin e parë publik me qytetarët për punën e tij dhe të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024.

Takimi publik u mbajt me datën 21.06.2024 (e premte) në sallën e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, duke filluar nga ora 14:00.

Në këtë takim qytetarët kishin mundësi të njoftohen për punën, të arriturat dhe sfidat e gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 si dhe zhvillimet aktuale.

Të drejte pjesëmarrje kishin të gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut.

Komentet dhe sygjerimet, qytetarët kanë pasur mundësi ti dërgonin deri me datën 23.06.2024 në ora 16:00. Email: besim.q.ilazi@rks-gov.net, fatlume.selimi@rks-gov.net

Njoftimi i publikuar në vebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/nees/njoftim-takimin-e-pare-publik-me-qytetare-kryetari-i-komunes-se-kacanikut-besim-ilazi-organizon-takimin-e-pare-publik-me-qytetaret-per-punen-e-tij-dhe-te-komunes-per-gjashtemujorin-e-pare-te-viti/>

[https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2024/06/13732-Ftese-per-Diskutim-Publik -Kryetari-i-Komunes.pdf](https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2024/06/13732-Ftese-per-Diskutim-Publik-Kryetari-i-Komunes.pdf)

Njoftimi i publikuar në platformën e komunës në facebook:

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

Gjatë takimit nuk pat ndonjë kërkesë konkrete, ndërsa me email janë pranuar disa kërkesa nga qytetari Faton Zharku:

1. Ndërtimi i urës për automjete dhe këmbësorë mbi lumin Nerodime te Xhamia e Dëshmorëve në Kaçanik;

Ura për këmbësorë dhe automjete, mbi Lumin Nerodime do të përfundohet brenda këtij viti.

Ne lidhje me hartat zonale pritet që Brenda këtij viti të kemi kontratën e lidhur me një ndërmarrje për hartimin e projektit Hartat Zonale për Komunën e Kaçanikut.

2. Zgjerimi i rrugës dhe ndërtimi i trotuarit nga Xhamia e Dëshmorëve deri te tuneli i trenit në Runjevë;-

- Ky projekt do të shqyrtohet të realizohet përmes kodit të projektit "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale rurale"

3. Vazhdimi i zgjerimi i rrugës 'Emsale Frangu' dhe ndërtimi i trotuarit nga Shkolla Filllore 'Emin Duraku' në Dushkajë deri në fund të rrugës;-

- Ky projekt do të shqyrtohet të realizohet përmes kodit të projektit "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale urbane"

4. Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit Nerodime nga Xhamia e Dëshmorëve në gjatësi prej 250 m;-

- Komuna ka të hartuar projektin ekzekutiv për vazhdimin e rregullimit të shtratit të lumit Nerodime në gjatësi totale **6383.72m**. Bazuar në mundësitë buxhetore të komunës, projekti nuk mund të përballohet si tërësi, por do të shikohen mundësitë e financimit nga ministritë e linjës.

5. Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit Lepenc në Bob në gjatësi prej 250 m;

- Komuna ka të hartuar projektin ekzekutiv për vazhdimin e rregullimit të shtratit të lumit Lepenc në gjatësi totale **5654.77m**. Bazuar në mundësitë buxhetore të komunës, projekti nuk mund të përballohet si tërësi, por do të shikohen mundësitë e financimit nga ministritë e linjës

- 6. Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit Lepenc në jug të qytetit në gjatësi prej 250 m;-Ne planifikimet e ardhshme të komunës së Kaçanikut do të shqyrtohet mundësia që

fillimisht të hartohet projekti detal që më pas, bazuar në koston e paraparë të projektit të shikohen mundësitë për financim.

7. Ndërtimi dhe asfaltimi i segmentit rrugor, Stagovë - Kaçanik i Vjetër;
 - Këtë vit është paraparë ndërtimi dhe asfaltimi i segmentit rrugor Runjevë-Stagovë në gjatësi 1800m kurse në vitet në vijim, bazuar në projektin e detajuar, do të implementohet edhe segmenti Stagovë - Kaçanik i Vjetër.
8. Zgjerimi i rrugës përgjatë përroit të Rakocit;
 - Ky Project është i koduar ne buxhetin e vitit 2024 dhe janë ndare mjete 72,279.00€.
9. Ndërtimi i trotuarit përgjatë magjistrales Kaçanik-Ferizaj për banorët e lagjes Dushkaja;
 - Ne planifikimet e ardhshme të komunës së Kaçanikut do të shqyrtohet mundësia që fillimisht të hartohet projekti detal që më pas, bazuar në koston e paraparë të projektit të shikohen mundësitë për bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës ngase rruga magjistrale Ferizaj-Kaçanik është në kompetence të kësaj ministrie.
10. Ndërtimi i trotuarit përgjatë magjistrales Kaçanik-Hani i Elezit për banorët e Bobit;
 - Në planifikimet e ardhshme të komunës së Kaçanikut do të shqyrtohet mundësia që fillimisht të hartohet projekti detal e më pas, bazuar në koston e paraparë të projektit të shikohen mundësitë për bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës ngase rruga magjistrale Kaçanik-Hani i Elezit është në kompetencë të kësaj ministrie.
11. Vendosja e reflektorëve në drejtim të Gurit të shpumë për ndriçimin e saj gjatë natës;
 - Si ide është e mirë por fillimisht duhet të shqyrtohet dhe analizohet arsyeshmëria dhe kostbenefiti i këtij projekti për banorët e komunës së Kaçanikut.
12. Ndërtimi i shtegut për këmbësorë dhe çiklistë nga Kaçaniku deri në Hanin e Elezit përgjatë lumit Lepenc;
 - Projekti është i koduar në listën e investimeve kapitale të komunës së Kaçanikut për vitin 2024, por kostoja e projektit tejkalon mundësitë buxhetore të komunës sonë.
13. Instalimi i Free Internet Zone në sheshin e qytetit;
 - Ideja e Free Internet Zone në këtë lokacion dhe lokacione tjera te qytetit do të shqyrtohet të realizohet përmes projektit Smart City, që aktualisht komuna është dukë e bërë studimin e fizibilitetit të këtij projekti.

14. Pastrimi dy herë në vit i shtratit të lumit Nerodime nga vendi ku bashkohen lumenjtë deri te Xhamia e Dëshmorëve;

- Praktika e pastrimit të shtratit të lumit Nerodime, është duke u zbatuar tash e disa vite. Me mjetet buxhetore të komunës është duke u bërë pastrimi një herë në vit.

15. Pastrimi me ujë çdo ditë në sezonin e verës (Korrik-Gusht) i bulevardit 'Ismail Raka'

- Pastrimi i bulevardit dhe rrugëve të qytetit me ujë po bëhet sipas nevojës përmes kontratës "Mirëmbajtja verore e rrugëve lokale"

16. Ndarja e një shtese të njehershme për familjet në rastin e lindjes së fëmijeve, për fëmijën e parë, 100 euro, për fëmijën e dytë, 200 euro, për fëmijën e tretë, 300 euro, etj.

- Për shkak të mundësive buxhetore kjo kërkesë momentalisht nuk mund të realizohet.

17. Krijimi i një ose dy paralele të mjekësisë në kuadër të shkollës së mesme;

- Në kuadër të planifikimit të DKA-së, nuk parashihet që të hapen paralele të mjekësisë. Arsye kryesore është mungesa e kuadrit dhe zvogëlimi i numrit të nxënësve.

18. Organizimi i turneut memorial të shahut 'Hakif Jusufi' me rastin e ditës së Çlirimit të Kaçanikut;

- DKRS në bashkëpunim me kryetarin e komunës organizon një seri aktivitetimesh kulturore, artistike e sportive të cilat organizohen në bashkëpunim me OJQ-të në këtë rast me KSH Lepenci , ku edhe turneun Memorial Hakif Jusufi jemi të gatshëm ta mbështesim një kërkesë të tillë në vitet në vazhdim.

19. Shpallja zonë turistike e vendbanimeve, një pjesë malore e Bobit, Gajra, Ivaja, Kotlina, Shtraza, Gllloboçica, Gjurgjedelli, Llanishta, Kërbliq, Dërnogllava.

- Me miratimin e Planit të ri Zhvillimor Komunal i cili është në finalizim e sipër, parashihen të shpallen zona të reja turistike të cilat gjenden në fshatrat: Kotlinë, Ivajë, Kërbliq , Krivenjevë dhe Sllatinë, ndërsa zona turistike aktuale në Strazhë do të zgjerohet. Gjithashtu do të ketë një zonë turistike në qytet në pjesën e zonës urbane saktësisht në Grykë të Kaçanikut si dhe pjesa e Gurit të Shpuar. Komuna e Kaçanikut poashtu ka propozuar që me Planin e ri Kombëtar për Parkun Nacional "Sharr", të parashihet një zonë turistike në Luboten dhe ndërtimi i teleferikut në këtë pjesë .

20. Hartimi i projektit të teleferikut nga Bobi deri te Guri i shpumë;

- Sa i përket hartimit të projektit të teleferikut Bob-Guri i Shpumë me Planin e ri Zhvillimor Komunal nuk parashihet në këtë distancë ndërtimi i teleferikut, por i njëjti kemi propozuar të ndërtohet nga fshati Strazhë për në Luboten, meqë në atë pjesë lidhen me mire zonat turistike dhe mendojmë që tërheqja e vizitoreve nga vendet e tjera do të jete me i qëlluar aty.

(**Verejtje :** Dy përgjigjet e cekura më lartë nuk janë të konkretizuara, të njëjtat mundë të pësojnë ndryshime deri në miratimin e Plani Zhvillimor Komunal nga Kuvendi Komunal. Plani Zhvillimor Komunal do t'i nënshtrohet dëgjimeve publike para miratimit dhe qytetarët do të kenë mundësinë që përmes propozimeve të tyre ta ndryshojnë atë.)

21. Themelimi vjetor i çmimit letrar për poezi dhe letërsi "Bedri Hysa"

- DKRS mbështet me subvencione organizatat kulturore dhe mirëpret çdo iniciativë e do të mbështes edhe Themelimin vjetor të çmimit letrar për poezi dhe letërsi 'Bedri Hysa';

22. Vendosja e TV digjital në sheshin e qytetit;

- Kjo ide do të shqyrtohet të realizohet në vitet në vijim duke ndërlidhur edhe me aktivitete tjera vjetore të parapara nga komuna për festat dhe ditët e shenuara

23. Shtimi i shërbimit të endokrinologjisë në kuadër QKMF-së;

- Specialisti i Endokrinologjisë nuk është i paraparë sipas statutit të QKMF-së, kurse me UA 04/2020 janë paraparë të bëhen analizat e hormoneve të tiroidesë T3,T4 dheTSH-ja!
-

24. Kino në Shtëpinë e Kulturës;

- Të gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut janë në dijeni se objekti i Shtëpisë së Kulturës momentalisht nuk i plotëson të gjitha kushtet për KINO pasi që edhe sistemi elektrik i vjetërsuar na e pamundëson një gjë të tillë. Jemi në pritje të një projekti për renovim të tërësishëm.

25. Mbjellja e jorgovanit nëpër qytet;

- Tashmë janë krijuar vende dhe vazo betoni në shëtitoret përgjatë lumit Nerodime

nga ura e Konakut deri te xhamia e dëshmorëve, ku mund të mbjellen lule të ndryshme njëvjeçare dhe shumëvjeçare.

25. Inicimi i procedurës për hartimin e Hartave Zonale;

- Së shpejti do të iniciohet procedura për hartimin e hartave zonale, që do të shkojnë së bashku me Planin Zhvillimor Lokal.

26. Ndërtimi i parkut në lagjen Dushkaja pas Shkollës Fillore “Emin Duraku”

- Trajtimi i hapësirave publike për ndërtimin e parqeve të ndryshme në lokacione ku ekziston mundësia është duke u implementuar çdo vit përmes kodit të projektit “Ndërtimi i parqeve dhe hapësirave publike”

Fatlume Guri Selimi

Zyra për Informim

